



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje ë Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

RAPORTI VJETOR



**PËR KONSULTIMET ME PUBLIKUN NË QEVERINË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2017**

Maj, 2018

Përmbajtja

<i>Lista e shkurtesave</i>	3
<i>Fjala hyrëse</i>	4
<i>1. Përmbledhje Ekzekutive</i>	6
<i>2. Hyrje</i>	7
<i>3. Rregullorja (QRK) Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimeve publike</i>	8
<i>4. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve</i>	9
<i>5. Mekanizmat për monitorimin e zbatimit të Rregullores Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimeve publike</i>	10
<i>6. Ndërlidhja e procesit të konsultimeve me publikun me zbatimin e indikatorëve</i>	11
<i>7. Platforma Online për konsultime publike</i>	13
<i>8. Ngritja e Kapaciteteve/Trajnimet për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik</i>	14
<i>9. Pilot projektet për zhvillimin e konsultimeve publike</i>	15
<i>10. Bashkëpunimi institucional dhe me shoqërinë civile për procesin e konsultimeve me publikun</i>	16
<i>11. Numri i projekt propozimeve –të konsultuar dhe jo të konsultuar</i>	17
<i>12. Plotësimi i Standardeve Minimale</i>	19
<i>13. Metodatat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve</i>	21
<i>14. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në proces të konsultimeve</i>	23
<i>15. Numri dhe statusi i komenteve</i>	24
<i>15. Përfundimet dhe sfidat</i>	26
<i>Shtojca 1: Tabela e të gjitha të dhënave të përmbledhura nga Ministrinë e linjës</i>	29

Lista e shkurtesave

DIEKP	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
IKAP	Instituti i Kosovë për Administratë Publike
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBZHRD	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MeD	Ministria e Diasporës
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integrimi
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë

Fjala hyrëse

Republika e Kosovës tashmë ka hyrë në vitin e dytë të zbatimit të standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike. Vitin 2017 e llogarisim një vit ku zbatimi i këtyre standardeve ka shënuar progres të jashtëzakonshëm, si në krijimin e mekanizmave dhe një mjedisi të shkëlqyeshëm të bashkëpunimit në mes të administratës publike, organizatave të shoqërisë civile dhe të gjitha palëve të interesuara gjatë hartimit të dokumenteve, të politikave dhe legjislacionit.

Këtë progres e paraqesim përmes këtij Raporti Vjetor i cili hartohet për herë të parë nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë /Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me të gjitha ministrinë e linjës përmes koordinatorëve për konsultime të emëruar në këto ministri.


Siç prezantohet në këtë raport, shkalla e përfshirjes së publikut në hartimin e dokumenteve qeveritare ashtu bazuar në Rregulloren për standardet minimale marrë parasysh faktorët dhe kohën e hyrjes së saj në fuqi, është mjaft e kënaqshme. Kjo tregon përkushtimin e të gjitha institucioneve që të përfshijnë publikun në procesin e zhvillimit të politikave të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

Transparenca është një nga faktorët kryesorë që ndikon në rritjen e llogaridhënies e si rezultat edhe në rritjen e performancës së administratës publike. Prandaj konsultimi i publikut i shërben rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike. Përveç kësaj ajo ndikon drejtpërdrejtë në kualitetin e politikave dhe vendimeve të institucioneve dhe si rezultat rrit shkallën e zbatimit të tyre. Procesi i konsultimeve publike i koordinuar dhe monitoruar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ndikon drejtpërdrejtë në avancimin e reformës në administratën publike në Republikën e Kosovës dhe përmbushjes së obligimeve të marra nga Qeveria për procesin e integritit e sidomos arritjen e objektivave dhe treguesve të përfshira në mbështetjen sektoriale buxhetore të ofruar nga Komisioni Evropian. Puna e shkëlqyeshme e bërë gjatë vitit 2017 por edhe në vitet paraprake, i atribuohet një angazhimi gjithëpërfshirës i të gjitha institucioneve që kanë konsultuar dokumentet, politika dhe legjislacioni gjatë vitit 2017, si dhe publikut e organizatave që përfaqësojnë kategori të caktuara të qytetarëve të cilët kanë qenë aktiv në vazhdimësi në dhënien e komenteve dhe rekomandimeve për këto dokumente.

Një kontribut të veçantë në ndërtimin e sistemit të konsultimeve publike kanë dhënë ekipi i projektit të Komisionit Evropian “Mbështetje zbatimit të strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile”.

Megjithatë, angazhim më i madh na pret gjatë viteve në vazhdim sidomos në adresimin e gjetjeve, rekomandimeve si dhe mësimave të mësuara gjatë procesit të konsultimeve publike gjatë vitit 2017. Hapat e ardhshëm dhe përqendrimi i shtuar gjatë vitit 2018 e më tutje do të jetë që procesi i konsultimit dhe monitorimi i punës nga ana e nivelit qendror të qeverisjes të

përqendrohet në ngritjen e kualitetit të konsultimeve në kuptimin e mobilizimit më të madh të publikut për të dhënë kontributin e tyre, rritjen e kualitetit të rekomandimeve dhe komenteve. Prandaj, për arritjen e këtij qëllimi do të shfrytëzojmë të gjitha kapacitetet që kemi, së bashku me institucionet, partnerët që na mbështesin, organizatat e shoqërisë civile dhe publikun e gjerë.



z. Habit Hajredini

Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

1. Përmbledhje Ekzekutive

Ky është raporti i parë vjetor për procesin e konsultimeve publike nga ana e dikastereve të Qeverisë sipas Rregullores Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimeve publike (më tutje Rregullores)¹. Raporti paraqet punën e bërë gjatë vitit 2017 në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike nga ana e Qeverisë, të udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, në bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të përfshira në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit.

Angazhimi i institucioneve në themelimin e mekanizmave përgatitorë në zbatimin e standardeve minimale është i shumanshëm. Gjatë vitit 2017 nën udhëheqjen e Zyrës për Qeverisje të Mirë, (vlen të përmenden edhe angazhimet e vitit 2016, meqë nuk janë raportuar më herët) janë themeluar strukturat koordinuese përfshirë këtu koordinatorët për konsultime publike në secilën ministri, ndërsa në shërbim të ngritjes së kapaciteteve të tyre janë organizuar trajnime të thelluara (dy runde trajnimesh) përfshirë trajnime në punë, për përdorimin e platformës elektronike si dhe punëtori të shumta informuese. Një nga hapat më të rëndësishëm që ka kontribuar dhe lehtësuar realizimin e konsultimit publik është funksionalizimi i platformës elektronike të konsultimit publik përmes së cilës kërkohet të konsultohen të gjitha dokumentet e parapara me rregullore.

Gjatë vitit 2017 konsultimit publik përmes platformës i janë nënshtruar 221 dokumente nga gjithsej 245 dokumente apo 90% të numrit të përgjithshëm të dokumenteve të miratuara në Qeveri. Këtu përfshihen 40 projekt ligje, 46 projekt rregullore, 92 projekt udhëzime administrative, 25 koncept dokumente, 09 draft strategji si dhe plani vjetor i punës së qeverisë së bashku me programin legjislativ, planin e koncept dokumenteve dhe planin e dokumenteve strategjike. Duhet cekur se 4 ministri (duke mos përfshirë ministrinë e reja) ose nuk kanë hartuar asnjë dokument që do të duhej ti nënshtrohet procesit të konsultimit publik ose nuk ka pasur informata për këtë.

Vlerësohet se 116 apo 52 % e dokumenteve të konsultuara i kanë plotësuar standardet minimale të cilat janë paraparë më rregullore ndërsa 105 apo 48% të tyre nuk i kanë plotësuar standardet minimale. Është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsej kanë marrë pjesë 2104 pjesëmarrës të cilët kanë bërë 1119 komente qoftë përmes takimeve, grupeve apo edhe me shkrim. Gjithsej 535 apo 48% % të komenteve janë marrë parasysh, 183 apo 16% e tyre pjesërisht janë marrë parasysh ndërsa 401 apo 36% të komenteve nuk janë marrë parasysh nga ana e institucioneve.

¹ Rregullore (QRK) Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, është miratuar në mbledhjen e 86 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/86, datë 29.04.2016.

Metodë kryesore përmes të cilës janë konsultuar dokumentet e hartuara nga Qeveria është platforma elektronike (e përdorur për 221 dokumente). Krahas kësaj, metodat e tjera që janë përdorur mjaft shpesh janë edhe komunikimi përmes postës elektronike gjegjësisht e-maili (i përdorur gjatë konsultimit të 90 dokumenteve), punëtoritë me palët e interesit janë përdorur për 30 dokumente, takimet publike janë përdorur për 9 dokumente, ndërsa takimet më palët e interesit janë përdorur për 3 dokumente. Përveç platformës dhe konsultimeve me e-mail, raportohet se takimet publike janë përdorur nga 4 ministri, takimet me palët e interesit janë përdorur nga 2 ministri, ndërsa punëtoritë me palët e interesit janë përdorur nga 2 ministri. Sipas raporteve nuk janë përdorur metoda të tjera.

Përveç punës që është bërë dhe shkallës së respektimit të standardeve minimale, ky raport evidenton sfidat dhe problemet e hasura gjatë punës së zbatimit të standardeve minimale por edhe jap rekomandimet e duhura për institucionet në mënyrë që të sigurohet proces sa më kualitativ i konsultimeve publike dhe raportim sa më të saktë i procesit.

2. Hyrje

Viti 2017 paraqet një kthesë pozitive në zhvillimin e konsultimit publik të dokumenteve që hartohen dhe miratohen nga ana e Qeverisë. Ky zhvillim ka rrjedhur si rezultat i hyrjes në fuqi të Rregullores(QRK) Nr. 05/2016 për standardet minimale të procesit të konsultimeve publike dhe angazhimit të gjithanshëm të institucioneve në zbatimin kërkesave të cilat dalin nga kjo rregullore. Përveç kësaj avancimi i zhvillimit të sistemit të konsultimit publik është një nga objektivat e Qeverisë i paraqitur përmes Programit të Qeverisë, Strategjisë për bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile dhe Strategjisë për Rregullim më të Mirë 2017-2021 si “*Komunikimi efektiv publik, konsultimi publik dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara*”.

Konsultimet me publikun janë vlerë themelore e Bashkimit Evropian, por edhe vlerë e qeverisjes së mirë, që ndihmon në bërjen e politikave më të mira dhe rrit besimin e qytetarëve në punën e institucioneve publike. Në kontekstin e përmbushjes së obligimeve nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, konsultimet kuptimplota me publikun dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në bërjen e politikave, janë parakusht themelor për sigurimin e reformës efektive të administratës publike, por kanë po ashtu ndikim pozitiv edhe në qëndrueshmërinë e reformave në të gjitha fushat tjera”. Zhvillimi pozitiv në këtë fushë është vlerësuar edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2018 i cili thekson se “*Konsultimet ndërministrrore dhe konsultimet publike janë rregulluar dhe është bërë progres në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve me publikun. Këto standarde kanë hyrë në fuqi në janar 2017 dhe u pasuan në shkurt 2017 me themelimin e platformën elektronike për konsultime ndër-ministrrore dhe publike*”.

Ky është raporti i parë vjetor i cili paraqet progresin, punën, sfidat dhe problemet në zhvillimin e konsultimeve publike nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Raporti ka për qëllim të jap informata të detajuara për politikë bërësit, zbatuesit të politikave dhe qytetarët në përgjithësi për zbatimin e standardeve minimale të procesit të konsultimit. Ky raport përveç informimit për punën e bërë në procesin e konsultimit, ka për qëllim identifikimin e ngecjeve, te metave dhe problemeve të cilat institucionet kanë hasur gjatë zbatimit të rregullores për standardet minimale. Përveç gjetjeve dhe sfidave Raporti gjithashtu paraqet rekomandimet të cilat duhet të merren parasysh nga Zyra e Kryeministrit dhe në veçanti Zyra për Qeverisje të Mirë, ministritë por edhe organizatat e shoqërisë civile për të siguruar një proces kualitativ të konsultimit me publikun me qëllim të përmirësimit të kualitetit të dokumenteve të cilat miratohen nga ana e Qeverisë.

Zhvillimi i sistemit të konsultimit publik paraqet kontribut të drejtpërdrejt për reformën e administratës publike. Përmes kësaj Raporti shërben për të pasqyruar rezultatet dhe progresin në këtë fushë të reformës. Ky raport gjithashtu paraqet prurjet për vlerësimin e arritjeve të Qeverisë në zbatimin e Kontratës së Mbështetjes Buxhetore Sektoriale nënshkruar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian pasi që konsultimi publik është edhe një nga kushtet e përfshira në këtë kontratë përmes një treguesi të veçantë.

3. Rregullorja(QRK) Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimeve publike

Rregullorja për standardet minimale për procesin e konsultimit publik e miratuar më 29 prill 2016 paraqet rregulla dhe standarde të cilat duhet të merren parasysh nga ana e institucioneve gjatë hartimit të dokumenteve publike për të ju mundësuar qytetarëve dhe shoqërisë civile që të jenë të përfshirë në formësimin e politikave publike.

Kjo Rregullore ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin e një procesi të konsultimit publik ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut, për një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e politikë bërjes dhe vendimmarrjes me interes publik si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së organeve publike ndaj palëve të interesuara dhe publikut. Me këtë Rregullore përcaktohen standardet minimale, parimet dhe procedurat në procesin e konsultimit publik, ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut, në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga të gjitha organet publike për të planifikuar dhe zbatuar në formë efektive procesin e konsultimeve publike gjatë hartimit të legjislacionit dhe politikave. Standardet minimale të përcaktuara me këtë rregullore zbatohen për të gjitha dokumentet, procesi i hartimit të të cilave kërkon konsultim publik. Projekt planet vjetore të organeve publike i nënshtrohen procesit të konsultimit me publikun në pajtim

me këtë Rregullore. Dokumentet e tjera të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit me publikun duke u bazuar në këtë Rregullore janë:

1. Projekt Plani vjetor i dokumenteve strategjike;
2. Projekt programi legjislativ i Qeverisë;
3. Projekt plani i akteve nënligjore;
4. Projekt lista e koncept dokumenteve
5. Projekt koncept dokumentet
6. Projekt aktet normative
7. Projekt strategjitë si dhe
8. Të gjitha dokumentet tjera, të cilat duhet të shoqërohen me memorandum shpjegues apo për të cilat kërkohet konsultimi me publikun.

Standardet minimale për konsultime publike të përcaktuara në këtë Rregullore zbatohen për të gjitha dokumentet, procesi i hartimit të të cilave kërkon konsultim publik nga data 01 janar 2017.

4. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve

Mbledhja e informatave dhe hartimi i këtij raporti është bërë sipas Metodologjisë së raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve minimale e cila është hartuar dhe finalizuar nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë Kjo metodologji pas procesit të konsultimeve është miratuar në fund të prillit 2017. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit, me qëllim të lehtësimit të punës së institucioneve dhe për të standardizuar procesin dhe formën e raportimit, përveç përshkrimit të procesit të raportimit dhe përgjegjësisë së secilës strukturë institucionale, përmban edhe formularët e bartjes së informatave apo raportimit nga institucionet përgjegjëse për zhvillimin e konsultimeve deri tek Zyra për Qeverisje të Mirë. Kjo metodologji gjithashtu përmban udhëzime të detajuara për përmbajtjen e raportit vjetor dhe me shembuj të paraqitur në formatin e raportit vjetor.

Gjatë kësaj periudhe platforma është përdorur nga shumica e institucioneve relevante. Zyra për qeverisje të mirë/ Zyra e Kryeministrit si koordinatorë e procesit të konsultimeve me publikun sipas Rregullores përmes koordinatorëve nëpër ministritë e linjës ka arritur që ta funksionalizoj dhe përditësoj platformën në baza të rregullta. Prandaj, burimi kryesor i informatave për hartimin e këtij raporti është platforma elektronike për konsultimet publike. Gjithashtu informata për përdorimin e metodave tjera të konsultimit janë marrë direkt nga ana e koordinatorëve përgjegjës për koordinimin e konsultimeve në secilën ministri përmes formularëve që janë pjesë e metodologjisë së raportimit. Informatat e pranuar nga koordinatorët dhe ato që janë marrë përmes platformës, janë verifikuar gjithashtu duke kontrolluar listën e vendimeve të miratuar nga Qeveria gjatë vitit 2017.

Duhet cekur se janë evidentuar vështirësi të theksuara gjatë mbledhjes së informatave për procesin e konsultimeve publike në nivel të disa institucioneve. Vështirësitë janë evidentuar për informatat të cilat nuk mund të gjenerohen nga ana e platformës për konsultim me publikun, sidomos për dokumentet të cilat nuk janë konsultuar përmes platformës, numrin e pjesëmarrësve, numrin e komenteve, ato që janë pranuar apo nuk janë pranuar, faktin se në çfarë shkalle është zhvilluar procesi kualitativ i konsultimit. Një mungesë e tillë e informatave është vërejtur në shumicën e dokumenteve për të cilat nuk janë publikuar raportet e konsultimit.

Duhet cekur se raporti nuk hyn në vlerësimin e kualitetit të procesit të konsultimit publik, megjithëse shpesh kualiteti i procesit të konsultimit mund të nënkuptohet në bazë të disa parametrave apo të dhënave statistikore që paraqiten në raport, sidomos nga statistikat e kontributeve dhe numrit të përfshirjes së tyre në dokumentet e miratuara.

5. Mekanizmat për monitorimin e zbatimit të Rregullores Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimeve publike

Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, sipas Rregullores nr. 05/2016 për standardet minimale për konsultime me publikun, është organi përgjegjës në koordinimin e procesit të konsultimeve. Sekretarët e përgjithshëm në secilën ministri kanë emëruar koordinatorët për konsultime me publikun. Koordinatorët e konsultimeve kanë përgjegjësinë e krijimit të një sistemi efektiv të raportimit për zbatimin e standardeve minimale për konsultim me publikun si dhe të mbështetjes së vazhdueshme të zyrtarëve përgjegjës për hartimin e politikës dhe legjislacionit.

Rrjedhimisht Zyra për Qeverisje të Mirë e ka marrë këtë përgjegjësi dhe sipas kësaj rregulloreje secila Ministri emëron koordinatorët e konsultimeve në ministrit të cilët janë pikë kontakti për Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe njëherit shërbejnë si koordinatorë të gjithë procesit në ministritë që përfaqësojnë. Deri tash kemi të emëruar 26 koordinatorë në secilën ministri dhe Zyra për Qeverisje të Mirë përmes koordinatorëve nëpër ministritë e linjës ka arritur që ta funksionalizojë dhe përditësoj platformën në baza të rregullta mujore e ditore. Sipas Rregullores për Standardet Minimale për procesin e konsultimeve publike Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me koordinatorët për konsultime me publikun përgatit raportet vjetore rreth procesit të konsultimit publik. Informatat rreth procesit të konsultimit publik mbledhen nga të gjitha organet publike, përmes koordinatorëve për konsultime me publikun të emëruar nga Sekretarët e Përgjithshëm apo pozita ekuivalente sipas nenit 20 të Rregullores. Zyrtarët përkatës për procesin e konsultimit me publikun do të mbledhin informatat vjetore për konsultimet e zhvilluara nga ana e organit përkatës tek zyrtari përgjegjës i caktuar nga organi publik për hartimin e politikës apo legjislacionit përkatës, i cili njëkohësisht është përgjegjës për zhvillimin e procesit të konsultimit me publikun. Raporti i konsultimit për secilin projekt propozim përgatitet nga ana e zyrtarit përgjegjës për procesin e konsultimit i cili gjithashtu është përgjegjës për udhëheqjen e punës në hartimin e dokumentit në fjalë. Raporti përfundimtar për procesin e konsultimit me publikun duhet të përmbaj të gjitha të dhënat nga procesi i konsultimit,

përfshirë palët e interesit të konsultuara, metodat e përdorura të konsultimit, kohëzgjatjen e procesit të konsultimit, numrin e kontributeve të pranuar nga secila metodë e konsultimit, numrin e kontributeve të përfshira plotësisht, pjesërisht dhe atyre që nuk përfshihen në projekt propozimin e hartuar dhe arsyen e mos përfshirjes së tyre, mbarëvajtjen e procesit të konsultimit dhe informata tjera të nevojshme për procesin e konsultimit.

Gjatë gjithë vitit 2017 Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si koordinator i procesit të zbatimit të standardeve minimale për konsultime publike sipas Rregullores nr. 05/2016, ka organizuar e mbajtur sesione e takime pune për Koordinatorët e Konsultimeve Publike nëpër Ministri.

Gjithmonë në këto aktiviteti janë diskutuar dhe prezantuar të dhënat e përditësuar të dokumenteve që janë publikuar nga ministrinë në platformën online, publikimi i kompletuar i dokumenteve për konsultim dhe raporteve përfundimtare mbi rezultatet e konsultimeve publike si dhe ndërlidhja e procesit të konsultimeve me indikatorët për përkrahje buxhetore për Reformën në Administratën Publike.

6. Ndërlidhja e procesit të konsultimeve me publikun me zbatimin e indikatorëve

Në kontekstin e përmbushjes së obligimeve nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, konsultimet kuptimplota me publikun dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në bërjen e politikave, janë parakusht themelor për sigurimin e reformës efektive të administratës publike, por kanë po ashtu ndikim pozitiv edhe në qëndrueshmërinë e reformave në të gjitha fushat tjera. Rrjedhimisht vlerësimin e indikatorëve të përcaktuar në kontratën e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për përkrahjen e drejtpërdrejt buxhetore në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit është një obligim që ne duhet ta përmbushim. Sipas kësaj marrëveshje konsultimi Publik duhet të zhvillohet sistematikisht përmes platformës publike për të pasur një pasqyrë të plotë të numrit të konsultimeve publike të kryera gjatë vitit. Numri i propozimeve të miratuara nga qeveria dhe propozimet që duhet të dorëzohen për konsultime publike duhet të vihen në dispozicion në Raportin Vjetor mbi zbatimin e Rregullores mbi Standardet Minimale të Proceseve të Konsultimeve Publike. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si monitorues për përcjelljen e platformës dhe raportimin e procesit të konsultimeve në linjë të zbatimit të kësaj marrëveshje të gjithë Sekretarëve të Përgjithshëm, ju është drejtuar me kërkesën që secila ministri të i përmbahen Rregullores për Standardet Minimale për Konsultime me Publikun dhe çdo dokument që hartohet në kuadër të ministrive që përfaqësojnë të i publikojnë në platformë për konsultime me publikun. Me indikatorët e performancës për Reformën e Administratës Publike që përdoren për përkrahjen e drejtpërdrejtë buxhetore të BE-së për Kosovën, parashihen që projekt strategjitë/politikat sektoriale/koncept dokumentet dhe ligjet primare, të cilat do të miratohen nga qeveria të jenë subjekt i konsultimeve publike në përputhje me Standardet Minimale për Konsultimin Publik. Me këtë rast është kërkuar nga Sekretarët e Përgjithshëm që ta përkrahni procesin e konsultimeve si dhe koordinatorët e procesit të konsultimeve në ministri.

Sipas indikatorëve të performancës për Reformën e Administratës Publike për përkrahjen e drejtpërdrejtë buxhetore të BE-së për Kosovën, parashihen që së paku 50% të projekt strategjive/politikave sektoriale/koncept dokumenteve dhe ligjeve primare, të cilat janë miratuar nga qeveria në vitin 2018 kanë qenë subjekt i konsultimeve publike në përputhje me Standardet Minimale për Konsultimin Publik, për vitin 2019- 70 % dhe për vitin 2020-100% duhet të plotësojnë kriteret për konsultim. Zyrat përgjegjëse në Zyrën e Kryeministrit/Zyra Ligjore, Zyra për Planifikim Strategjik dhe Sekretaria Koordinuese e Qeverisë do të sigurojnë që kërkesat e konsultimit publik të zbatohen në përputhje me angazhimet e parashtruara në pasaportën e treguese për Strategjinë për rregullim më të mire. Të tre zyrat do të raportojnë për konsultimet për strategjitë, koncept dokumentet dhe ligjet. Ky informacion do të ndahet drejtpërsëdrejti me BE-në dhe ZQM-ja për qëllimet e raportimit. Metodologjia e Standardeve Minimale përcakton hapat e mëposhtëm për qeverinë për të planifikuar dhe zbatuar konsultimet publike:

- Planifikimi i konsultimeve - zhvillimi i planeve të konsultimit për secilën strategji, koncept dokumentet dhe propozimi legjislativ (neni 11 i Standardeve Minimale)

- Përgatitja e një dokumenti konsultimi për çdo projekt-akt ligjor të publikuar në platformën online (shpjegimi i problemeve dhe objektivave kryesore, qëllimi i konsultimit, ndikimi i pritur në grupet e synuara, çështjet kyçe të adresuara nga projekt-politika / akti etj.)

- Kryerja e konsultimeve publike për të paktën 15 ditë pune (ose 3 javë) përmes platformës online si dhe

- Përgatitja e një raporti përfundimtarë me rezultatet e konsultimeve publike (me pasqyrën e përpunimit të arsyeve për pranimin / refuzimin e komenteve të caktuara) dhe botimin e tij në platformën online.

Rregullorja e Punës së Qeverisë, përkatësisht neni 7 paragrafi (3.3) parasheh mundësinë e shkurtimit të afatit të konsultimeve me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit. Rrjedhimisht edhe Rregullorja(QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, në Nenin 16 parasheh (Përrjashtimin nga detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik) ku në paragrafin 2 parashihet që arsyet për zbatimin e procedurës së përshpejtuar duhet të i komunikohen publikut, nëpërmjet mënyrave të njoftimit të parashikuar në këtë Rregullore.

Shkurtimi i afatit të konsultimit publik dhe ndikimit në vlerësimin e indikatorëve të përcaktuar në kontratën e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për përkrahjen e drejtpërdrejtë buxhetore në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit, në Nenin 16 të rregullores (Përrjashtimin nga detyrimi për njoftim dhe konsultim publik) dhe Nenin 17 (Kufizimet), kur procesi i konsultimit publik ka arsyet për zbatimin e procedurës së përshpejtuar të komunikuar për publikun atëherë nuk do të ndikoj në vlerësim të indikatorit

Këtë proces për arritjen e përmbushjes së këtyre indikatorëve po e përkrah edhe projekti i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian në Ministrinë e Administratës Publike “Mbështetje për Zbatimin e Reformës në Administratën Publike” përmes Novus Consulting dhe ekspertëve të angazhuar në këtë projekt.

7. Platforma Online për konsultime publike

Siç është kërkuar nga rregullorja për standardet minimale për konsultim publik Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, kanë zhvilluar Platformën Online, e cila siguron zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike. Lansimi i platformës është bërë me 22 shkurt 2017. Platforma Online është një pikë qasjeje për të gjitha konsultimet publike të kryera nga Institucionet publike për projektligje, koncept dokumente, dokumente strategjike dhe akte të tjera që janë subjekt i konsultimeve publike. Kjo platformë ofron mundësinë që të gjitha palët të jenë të ftuara dhe të përfshira në procesin e konsultimit publik për nismat legislative dhe procesin e vendimmarrjes dhe të politikë bërjes. Pas realizimit të konsultimeve publike, publikohen raportet e ministrive të linjës dhe agjencive përkatëse mbi rezultatet e konsultimeve publike së bashku me arsyetimet për propozimet e pranuar dhe ato të refuzuara. Bazuar në rregullore, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, obligohet të menaxhojë dhe mirëmbajë platformën online, të cilën e shfrytëzojnë të gjitha organet publike për të identifikuar hisedarët për zhvillimin e konsultimit me publikun (Fig. 1).

The image shows a screenshot of the website konsultimet.rks-gov.net. The header includes the logo of the Republic of Kosovo and the Government Office. The main navigation menu contains: Ballina, Lajmet, Rreth platformës, Institucionet, Kerko konsulta, Standardet e konsultimeve, Dokumentet, Kontaktet, Kyq, and Regjistrohu. The main content area features a banner with the text "Mirë se vini në platformën e konsultimeve publike - Bëjeni zërin tuaj të dëgjohet" and a megaphone icon labeled "MERR PJESË!". Below the banner are three columns of content: 1. "Rreth Platformës" with an image of a modern building and text about the regulatory framework. 2. "Sesion Pune me Koordinatorët e Konsultimeve Publike" with an image of a meeting and text about the process. 3. "Konsultimet e fundit" with a diagram of people and text about administrative drafts and projects.

Figura 1: Platforma për konsultime publike konsultimet.rks-gov.net

Qëllimi i kësaj platforme është që të ndihmojë ministrinë dhe agjencitë qeveritare të Republikës së Kosovës për procesin e konsultimeve publike, me përfshirjen më të gjerë të autoriteteve publike dhe joqeveritare, organizatave të shoqërisë civile dhe të gjithë partnerëve relevantë që janë përgjegjës për bërjen e politikave vendimmarrëse.

Platforma online edhe sipas shoqërisë civile është e arritur edhe për vetë CiviKos-in, që është angazhuar në avancimin e një mjedisi sa më të favorshëm në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve të shtetit.

8. Ngritja e Kapaciteteve/Trajnimet për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të institucioneve dhe përgatitjen e tyre për zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun, qysh në vitin 2016 /Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ka organizuar dhe mbajtur trajnime për zyrtarët në ministritë e linjës me ç' rast janë realizuar dy raunde të trajnimit për nëpunësit civil.

Raundi i parë i sesioneve të trajnimeve është mbajtur nga data 11 deri më 14 korrik 2016 në Prishtinë, me përfshirje të rreth 50 zyrtarëve të shërbimit civil. Në këtë trajnim janë përfshirë të gjitha ministritë me përfaqësues nga Zyra ose Departamentet Ligjore, nga Zyra e IT, Zyra e Planifikimit Strategjik, Zyra e Integritimit ose nga Zyra për Informim.

Raundi i dytë i sesioneve të trajnimeve është mbajtur nga data 26 deri më 30 shtator 2016. Fokusi i raundit të dytë të trajnimeve ka qenë demonstrimi praktik i standardeve dhe praktikave të konsultimeve publike ndërkombëtare dhe evropiane duke i njoftuar të pranishmit me kërkesat kryesore të rregullores së re dhe detyrat e zyrtarëve kryesorë, planifikimin e procesit të konsultimeve publike, dhe prezantimin e platformës online për konsultime publike.

Qëllimi kryesor i trajnimeve ka qenë trajnimi i koordinatorëve të ministrive për procesin e konsultimeve publike të cilët sipas Rregullores, secila ministri i emëron më qëllim të koordinimit të punës dhe përcjelljen e zbatimit të standardeve.

Koordinatorët e emëruar janë përgjegjës në krijimit të një sistemi efektiv të raportimit për zbatimin e standardeve minimale për konsultim me publikun si dhe të mbështetjes së vazhdueshme të zyrtarëve përgjegjës për hartimin e politikave dhe legjislacionit nga Ministritë e linjës. Ata bëjnë mbledhjen e raporteve për konsultim me publikun të përgatitura nga zyrtarët përgjegjës nëpër ministritë relevante për periudhën kohore përkatëse siç përcaktohet me Rregullore, përgatitjen e raportit të unifikuar vjetor lidhur me zbatimin e standardeve minimale për konsultim me publikun në nivel të institucionit publik përkatës, i cili dorëzohet në Zyrën për Qeverisje të Mirë. Ato po ashtu ofrojnë këshilla të nevojshme për zyrtarët përgjegjës për zbatimin efektiv të standardeve minimale për konsultim me publikun si dhe shërbejnë si pika të kontaktit për Zyrën për Qeverisje të Mirë për zbatimin e kësaj Rregulloreje.


Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, edhe gjatë vitit 2017 ka organizuar 4 punëtori (me 27 janar, me 17 Mars, me 3 maj dhe me 15 shtator 2017) dhe takime të shumta me koordinatorët përgjegjës (gati çdo muaj) të institucioneve për konsultime me publikun. Në këto punëtori janë diskutuar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me publikimet në Platformën Online për Konsultim me Publikun, raportimet e rezultatet të këtyre konsultimeve si dhe çështje tjera që janë në proces të zhvillimit të Platformës.

Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me Zyrën për Komunikimin Publik në ZKM si dhe me përkrahjen e projektit të SIDA-s dhe projektin e BE-se për mbështetjen e zbatimit të strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, kanë organizuar trajnimin “Komunikimi dhe konsultimet publike”. Trajnimi është mbajtur më 28-29 qershor 2017. Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë fuqizimi i kapaciteteve për të komunikuar procesin e konsultimeve publike gjatë procesit të zhvillimit të politikave

9. Pilot projektet për zhvillimin e konsultimeve publike

Në shkurt 2017, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me përkrahje të Projektit të BE-së "Mbështetje për implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë civile" si dhe më mbështetje të Projektit nga SIDA, dhe Ministria e Administratës Publike kanë realizuar dy pilot projektet e para të konsultimeve publike duke u bazuar në Rregulloren për standardet minimale. Gjatë këtyre sesioneve janë konsultuar dy projekt koncept dokumente: Draft Koncept Dokumenti për Shërbimin Civil si dhe Draft Koncept Dokumenti për Organizimin e Administratës Publike të Republikës së Kosovës” të cilat paraprakisht janë publikuar në platformën online.

Sipas rregullore, është realizuar edhe pilot konsulta e tretë, ku në këtë rast është përfshirë Ministria e Financave me konsultimi për Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme.



Këto tri pilot Konsultime të ndihmuara nga projekti e BE-së si metoda konsultimi kanë përdorur platformën, konsultimin me shkrim apo me e-mail si dhe janë zhvilluar takime publike me palët e interesit. Në platformë janë publikuar dokumentet e konsultimit dhe raportet e konsultimit me të gjitha informatat e nevojshme sipas Rregullores për standardet minimale.

Si rezultat Koncept dokumentit e për shërbimin civil dhe koncept dokumentit për organizimin e administratës publike kanë pasur nga 122 pjesëmarrës² ndërsa konsulta për projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme ka pasur 117 pjesëmarrës gjatë tri takimeve publike.

Konsiderohet se procesi i pilot konsultimit ka kaluar suksesshëm duke marrë parasysh kualitetin e procesit të konsultimit i cili mund të konstatohet nëse shikohet shkalla e pjesëmarrjes si dhe numri i komenteve. Duhet cekur se procesi i konsultimit të këtyre tri pilot konsultimeve dhe format e dokumenteve të publikuara ka pasur për qëllim dhe ka shërbyer si shembull për t'u ndjekur nga ana e institucioneve.

10. Bashkëpunimi institucional dhe me shoqërinë civile për procesin e konsultimeve me publikun

Me qëllim të rritjes së kualitetit të procesit të konsultimeve Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit dhe shumë partnerë dhe bashkëpunëtorë kemi punuar në zhvillimin dhe avancimin e procesit të konsultimeve. Vlen të përmendim bashkëpunimin dhe partneritetin që e kemi me Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), ku bashkë kemi nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkëpunim në realizimin e Trajnimit pasues mbi Standardet Minimale të Konsultimeve Publike. Memorandumi është një marrëveshje e përgjithshme në mes të dy subjekteve për hartimin dhe zbatimin e programit të ngritjes së kapaciteteve të shërbyesve civil dhe organizatave të shoqërisë civile për procesin e konsultimeve publike. Pra, ngritja e kapaciteteve është bërë paralelisht edhe për institucionet nga Zyra për Qeverisje të Mirë e edhe për OJQ-të nga ana e KCSF përmes ekspertëve. Gjatë gjithë kohës Zyra për Qeverisje të Mirë me qëllim të avancimit të platformës elektronike ka marrë parasysh dhe bashkëpunuar me KCSF e veçanërisht në rekomandimet që ata i kanë ofruar dhe të gjitha i ka përfshirë dhe është duke i përfshirë në zhvillim të platformës

- Funkcionalizimin e plotë të mundësisë së regjistrimit të përdoruesve të rinj duke evituar pengesat që pamundësojnë regjistrimin.
- Mundësimi i publikimit online të planeve të punës së qeverisë dhe ministrive së bashku me mundësinë e shprehjes së interesit/abonimit për elemente të veçantë të secilit plan.
- Mundësimi i publikimit online të takimeve për konsultim publik, së bashku me materialet përcjellëse dhe përgatitore e raportuese.


² Këto dy konsulta kanë pasur numër të njëjtë të pjesëmarrësve pasi që procesi i tyre i konsultimit është zhvilluar në pako, d.m.th. janë konsultuara në takime publike gjatë ditës së njëjtë dhe me pjesëmarrës të njëjtë.

- Mundësimi i publikimit të versionit të përditësimit të projekt propozimit pas trajtimit të komenteve të pranuar gjatë konsultimit publik.
- Automatizimi i njoftimeve të abonuesit për secilin proces të hapur të konsultimit publik, duke ua pamundësuar shërbyesve civil evitimin manual të dërgimit të njoftimit te palët e interesuara.
- Emërtimi i veçantë i njoftimeve të dërguara nga Platforma Online, duke evituar emërtimit standard unik pavarësisht llojit dhe përmbajtjes së njoftimit³.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë gjithashtu ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Përmes kësaj marrëveshje palët kanë shprehur vullnetin e tyre për themelimin të marrëdhënieve bashkëpunuese për forcim të mëtejshëm të ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve për standardet minimale të procesit të konsultimeve publike. Programi i trajnimit ishte i fokusuar në tre komponentë, standardet minimale të procesit të konsultimeve publike, kontraktimin e Organizatave të Shoqërisë Civile për shërbimet publike dhe për komponentin e krijimit të Sistemit për Financim të Organizatave të Shoqërisë Civile.

11. Numri i projekt propozimeve –të konsultuar dhe jo të konsultuar

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017 Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar 245 dokumente të cilat sipas rregullores për standardet minimale duhet ti nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Sipas informatave të ofruara nga 245 dokumente të hartuara gjithsej janë konsultuar 221 ndërsa vetëm 24 nuk i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik (shih Fig. 3).



³http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/03_04_2018_7635999_Platforma_Online_gjate_2017_KCSF.PDF

Siç shihet nga tabela në vijim numri më i madh i dokumenteve të cilat janë hartuar nga dikasteret qeveritare i përkasin kategorisë së akteve nënligjore, ku prijnë udhëzimet administrative (96 udhëzime administrative, 92 nga to janë konsultuar ndërsa 4 nuk kanë kaluar në proces të konsultimit) pastaj rregulloret (gjithsej 55 rregullore 9 nga to nuk kanë kaluar në proces të konsultimit) dhe 42 projekt ligje nga to 2 nuk kanë kaluar në proces të konsultimit publik (tabela nr. 1).

Lloji i projekt propozimit	Numri i atyre që është zhvilluar procesi i konsultimit	Numri i atyre që nuk është zhvilluar procesi i konsultimit	Totali
Draft Koncept Dokumente	25	4	29
Draft Ligje	40	2	42
Draft Plane te Veprimit	4	0	4
Draft Rregullore	46	9	55
Draft Udhëzime Administrative	92	4	96
Draft Dokumente strategjike	9	5	14
Tjetër	5	0	5
Totali	221	24	245

Tabela 1. Kategorive e Dokumenteve të konsultuara dhe jo të konsultuara

Duhet cekur se në listë të dokumenteve jo të konsultuara nuk janë përfshirë ato të cilat sipas nenit 17 të rregullores janë të përjashtuara nga procesi i konsultimit. Numri më i madh i dokumenteve që janë miratuara nga qeveria e që hyjnë në këtë kategori janë marrëveshjet ndërkombëtare. Gjithashtu në listë të dokumenteve nuk janë përfshirë ligjet të cilat si rezultat i shpërbërjes së Kuvendit janë kthyer serish në Qeveri për miratim ndërsa janë miratuar prapë nga Qeveria pas themelimit të saj. Duhet theksuar se gjatë hartimit të këtyre projekt ligjeve dhe miratimit të tyre nga Qeveria platforma e konsultimeve publike nuk ishte e funksionalizuar. Këtu përfshihen:

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollimin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214
- Projektligji për infrastrukturën Kritike
- Projektligji për Standardizim
- Projektligji për Shoqëritë Tregtare
- Projektligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinë
- Projekt Kodi i Drejtësisë për të Mitur


- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-007 për procedurën jo Kontestimore
- Projektligji për Ndërmjetësim
- Projektligji për Noterinë
- Projektligji për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik
- Projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë.

12. Plotësimi i Standardeve Minimale

Për të siguruar një proces konsultativ dhe përfshirje të të gjitha palëve të interesit gjatë hartimit të dokumenteve që miratohen nga dikasteret qeveritare Rregullorja për Standardet minimale parashih procedurat e qarta të cilat duhet të përcillen nga ana e institucioneve bartëse të hartimit të dokumenteve. Megjithëse nënshtrimi i një procesi të konsultimit përmes publikimit të dokumenteve përmes platformës është një parakusht dhe një nga standardet që secili dokument që hyn në kategorinë e nenit 5 të Rregullores, procesi i konsultimit nuk mund të konsiderohet i suksesshëm nëse nuk i nënshtrohet disa hapave tjerë gjatë procesit të konsultimit. Këtu hyjnë: *planifikimi i procesit të konsultimit* (neni 11 i Rregullores) i cili parashih, përcaktimin e kornizës kohore të procesit të konsultimit me publikun; Identifikimin e palëve të interesuara dhe publikut për procesin e konsultimit publik; Identifikimin e burimeve, mjeteve, formave dhe mënyrave të nevojshme për procesin e konsultimit publik; Përcaktimin e mënyrës së mbledhjes së përgjigjeve/rekomandimeve përkatëse dhe adresimin e tyre. Si faze e dytë e zhvillimit të procesit të konsultimit hyn *zhvillimi i procesit të konsultimit* i cili fillon pas finalizimit të draftit të dokumentit dhe finalizimit të konsultimit paraprak të paraparë me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

Ndërsa faza e fundit e procesit të konsultimit është *mbledhja e komenteve*, adresimi dhe publikimi i informatave për procesin e konsultimit dhe rezultateve të konsultimit publik.

Pas analizës së informatave të dërguara nga ana e institucioneve konsiderohet se nga numri i përgjithshëm i dokumenteve të konsultuara (221 dokumente – shih tabelën e lartë) Standardet minimale të parapara me rregullore i plotësojnë gjithsej 116 dokumente apo 52% ndërsa numri i dokumenteve që nuk e kanë plotësuar ndonjërin nga standardet është 105 apo 48 % të dokumenteve.



Sipas tabelës në vazhdim (tabela nr. 2) institucionet të cilat kanë qenë më strikte në plotësimin e standardeve minimale hyjnë MFSK vlerësohet se kanë plotësuar standardet në 7 dokumente të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimeve ndërsa MAPL në të gjitha 6 dokumentet e konsultuara kanë kaluar në të gjitha fazat dhe kriteret e konsultimit që parashihen me rregullore. Institucione të cilat gjithashtu kanë shkallë të lartë të përcjelljes së standardeve minimale hyjnë ZKM ku nga 18 dokumente që kanë kaluar në proces të konsultimit vetëm një nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas rregullores. Nivelin e plotësimit në mbi 60% e kanë gjithashtu dokumentet e konsultuara nga MTI, MMPH, MF, MI, MAP.

Ndërsa në anën tjetër institucionet që nuk qëndrojnë mirë më respektimin e standardeve minimale hyjnë Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale, me 17 dokumente ku asnjëra nuk ka plotësuar ndonjërin nga standardet minimale, p.sh. asnjëri nga dokumentet e konsultuara nuk ka pasur raport të konsultimit të publikuar. Pastaj MPB nga 36 dokumente të hartuara vetëm 2 kanë plotësuar të gjitha standardet minimale ndërsa tjerat nuk kanë plotësuar standardet gjegjësisht nuk kanë publikuar raportin e konsultimit. Në kategorinë e institucioneve numri i dokumenteve që nuk kanë plotësuar standardet minimale është i lartë është edhe MZHE-ja e cila nga 19 dokumente 4 nga to nuk ka plotësuar standardet minimale. Kriteri që nuk është plotësuar nga MZHE për shumicën e dokumenteve është mospublikimi Raportit të Konsultimit në platformën e konsultime publike i cili kërkohet me nenin 15 para. 3.3 të Rregullores për Standardet Minimale. Në këtë grup hyjnë edhe MD, MIE, MeD, MSH. (Tabela nr.2)

Institucioni	Numri i propozimeve të konsultuara	Numri i konsultave që plotësojnë standardet minimale	Nr. konsultave që NUK plotësojnë standardet minimale
ZKM	18	17	1
MZHE	19	5	14
MTI	22	17	5
MPMS	17	0	17

MPB	36	2	34
MMPH	28	20	8
MFSK	7	7	0
MF	9	7	2
MAPL	6	6	0
MI	38	29	9
MAP	7	4	3
MeD	1	0	1
MD	9	2	7
MIE	2	0	2
MSH	1	0	1
MKRS	1	0	1
MBZHRD	0	0	0
MASHT	0	0	0
MPJ	0	0	0
MKK	0	0	0
Totali	221	116	105

Tabela 2. Dokumente të konsultuara dhe të pa konsultuara sipas ministrive

13. Metodave të përdorura gjatë procesit të konsultimeve

Përzgjedhja e metodave të përshtatshme të konsultimit paraqet një nga faktorët shumë të rëndësishëm për një proces të suksesshëm të konsultimit. Përzgjedhja e metodave bëhet duke ju përshtatur palëve të interesit të cilat parashihet të japin kontributin në hartimin e dokumentit që konsultohet.

Konsultimi përmes platformës elektronike të konsultimit është një nga standardet minimale që parashihet me rregullore (neni 12). Megjithatë përdorimi i platformës nuk përjashton përdorimin e metodave të tjera të konsultimit (neni 12 para. 10) të cilat janë paraparë me nenin 7 të Rregullores e që përfshijnë:

- Konsultimet në formë të shkruar dhe elektronike;
- Publikimi në ueb faqe;
- Takimet publike;
- Konferencat;
- Takimet me grupet e interesit;
- Sesionet e punës;
- Intervistat/ Takimet kokë me kokë;
- Hulumtimet e opinionit

- Votim i diskutimit;
- Panelet me qytetarë;
- Tezgat (shtandet) në rrugë.

Siç është cekuar edhe më lartë dhe sipas tabelës së mëposhtme 221 dokumente janë publikuar në platformë për konsultim. Numri më i madh i dokumenteve të publikuara në platformë përfshijnë aktet nënligjore (92 udhëzime dhe 46 Rregullore) pastaj vijnë numri i ligjeve (40 ligje). Përveç publikimit në platformë 90 dokumente (apo 40.7 % të numrit të përgjithshëm të dokumenteve të konsultuara) janë konsultuar përmes metodës më shkrim elektronik, gjegjësisht përmes e-mailit. Përveç kësaj gjithashtu 30 dokumente apo 13.5% janë konsultuar përmes punëtorive, 9 dokumente janë konsultuar përmes takimeve publike ndërsa 3 tjera janë konsultuar përmes takimeve të drejtpërdrejta me grupe të interesit. Metodatat tjera si konferencat, takimet sy me sy, hulumtimet e opinionit, etj. nuk janë përdorur apo ministritë nuk i kanë raportuar se janë përdorur (tabela nr. 3).

	Konsultime me shkrim	Platforma	Takime publike	Konferenca	Takime me grupe të interesit	Punëtori	Intervista/takime sy me sy	Hulumtimet e opinionit	Votimi diskutues	Panelet me qytetarë	stendat në rrugë	tjetër
Koncept Dokumente	12	25	2	0	1	6	0	0	0	0	0	0
Draft Ligje	15	40	4	0	0	2	0	0	0	0	0	0
Plane të Veprimtimit	2	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Draft Rregullore	29	46	3	0	1	4	0	0	0	0	0	0
Udhëzime Administrative	29	92	0	0	1	17	0	0	0	0	0	0
dokumente strategjike	3	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Tjetër	0	5	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Totali	90	221	9	0	3	30	0	00	0	0	0	0

Tabela 3. Metodatat e përdorura të konsultimeve

Institucionet të cilat kanë përdorur më së shumti metoda të konsultimeve janë MPMS e cila përveç publikimit në platformë ka përdorur edhe konsultimin me shkrim, takime publike, takime me grupe të interesit dhe punëtori. Gjithashtu metoda të ndryshme të konsultimit përveç publikimit në platformë ka përdorur MAP-it (4 metoda të konsultimit) pastaj MTI, MF dhe MAPL kanë përdorur 3 metoda të konsultimeve (tabela nr. 4)

	Konsultim e me shkrim	Platforma	Takim e publike	Konferenc a	Takime me grupe te interesit	Punëtori	Numri i metodave te përdorura
ZKM		✓					1
MZHE	✓	✓					2
MTI	✓	✓			✓		3
MPMS	✓	✓	✓		✓	✓	5
MPB	✓	✓					2
MMPH		✓					1
MFSK	✓	✓					2
MF	✓	✓	✓				3
MAPL	✓	✓	✓				3
MI		✓					1
MAP	✓	✓	✓			✓	4
MeD		✓					1
MD		✓					1
MIE		✓					1
MSH		✓					1
MKRS		✓					1
MBZHR D							
MASHT							
MPJ							
MKK							

Tabela 4. Metodave të konsultimit të përdorura sipas ministrive

14. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në proces të konsultimeve

Pjesëmarrja e palëve të interesit gjatë procesit të konsultimit ka ndikim të drejtpërdrejtë në shkallën e kontributeve të ofruara për dokumentet të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit. Platforma elektronike e konsultimeve si instrument obligator dhe kryesor i procesit të konsultimeve është e qasshme gjatë gjithë kohës dhe për secilën kategori të qytetarëve që mund të qaset në internet. Megjithëse dokumentet të cilat janë të qasshme përmes platformës, (ose përmes ueb faqeve zyrtare të institucioneve) mund të kenë pjesëmarrje mjaft të gjerë, ku secili mund të njoftohet me përmbajtjen e dokumenteve që konsultohen, numri i pjesëmarrjes përmes kësaj forme regjistrohet vetëm nëse palët e interesit dërgojnë komente tek institucioni hartues. Ndryshe qëndron situata me llogaritjen e pjesëmarrjes gjatë përdorimit të metodave të tjera të

konsultimit, p.sh konferenca, takime publike kur numri i pjesëmarrjes llogaritet sipas prezencës së palëve të interesit pavarësisht se a kanë bërë komente për dokumentin që konsultohet.

Në rastin e konsultimit të dokumenteve të hartuara ne rastin tonë nga gjithsej 221 dokumente të konsultuara, gjithsej janë regjistruar 2104 pjesëmarrës. Numër të madh të pjesëmarrësve e ka të regjistruar MTI ku për 23 dokumente ka raportuar për pjesëmarrjen e 737 pjesëmarrësve, MAPL për 7 dokumente të konsultuara kemi 383 pjesëmarrës, MMPH për 20 dokumente ka raportuar 349 pjesëmarrës, ndërsa MAP-i për 8 dokumente të konsultuara ka raportuar për 312 pjesëmarrës pastaj ministria e financave 141 pjesëmarrës (Fig. nr. 7 seksionin 13 në vijim) .

15. Numri dhe statusi i komenteve


Qëllimi kryesor i ofrimit të kontributeve nga ana e palëve të interesit është përmirësimi i kualitetit të dokumenteve që hartohen dhe reflektimit të interesave të grupeve të interesit. Përzgjedhja e metodave adekuatë dhe shkalla e pro-aktivitetit të institucioneve që hartojnë dokumentet ka ndikim në rritjen e pjesëmarrjes dhe kualitetit të kontributeve që ofrojnë qytetarët dhe grupet e caktuara. Përveç kësaj ndikim kanë edhe aktivitetet dhe angazhimi i organizatave dhe grupeve të organizuara të cilat përfaqësojnë kategori të caktuara të qytetarëve.

Gjatë vitit 2017 nga 221 dokumente të cilat kanë kaluar në proces të konsultimit, 80 prej tyre kanë marrë komente, 100 dokumente, nuk kanë marrë asnjë koment ndërsa për 41 dokumente nuk ka informata nëse kanë marrë ndonjë koment (fig. nr 5).




Numri i përgjithshëm i komenteve të pranuar për gjithsej 80 dokumente është 1119. Llogaritet

se mesatarisht janë propozuar 8.7 komente për secilin dokument. Sa i përket statusit të komenteve llogaritet se nga 1119 komente 535 ose 48% e tyre janë pranuar nga institucionet hartuese, 183 apo 16% prej tyre janë pranuar pjesërisht ndërsa 401 ose 36% janë refuzuar.



Në grafikun në vazhdim pasqyrohen informatat krahasuese sipas ministrive për numrin e dokumenteve të konsultuara, numrit të pjesëmarrësve dhe numri i komenteve. Vlen të theksohet se pjesëmarrja e publikut në procesin e konsultimeve sipas të dhënave ndryshon nga ministria në ministri. Shpesh kjo pjesëmarrje nuk varet nga numri i konsultave apo numri i pjesëmarrësve në proces të konsultimit. P.sh. Nëse shikohet rasti i MTI-së, numri i pjesëmarrësve është jashtëzakonisht i ulët (24 komente) ndërsa kemi 22 dokumente të konsultuara dhe një numër shumë të madh të pjesëmarrësve në proces të konsultimit. Pastaj shembull i kundërt është rasti i MAPL-së i cili ka vetëm 6 konsulta 383 pjesëmarrës dhe 196 komente (fig. nr. 7).



15. Përfundimet dhe sfidat

Megjithëse historia e konsultimeve publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës nuk nis me miratimin e Rregullore për standardet minimale, pasi që një segment i tillë është rregulluar edhe me Rregulloren e Punës së Qeverisë, sukcesi i punës dhe kthesa në zbatimin e procesit të konsultimit lidhet me këtë rregullore.

Standardet minimale paraqesin kërkesa të shumta procedurale gjatë hartimit të dokumenteve publike, megjithatë sfidat reale paraqiten tek sigurimi i një procesi kualitativ me qëllim të kontributit sa më të mirë të palëve të interesit. Viti i parë i zbatimit të standardeve i cili pasqyrohet përmes këtij raporti paraqet një tregim sukcesi sa i përket ndikimit të standardeve të përcaktuara në këtë rregullore në proces të konsultimit. Angazhimet gjatë vitit të parë kanë qenë shumë-dimensionale si në drejtim të zhvillimit të sistemit të konsultimeve publike, ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit në praktikë të konsultimeve publike. Viti 2017 ka paraqitur një bazë të qëndrueshme për avancimin të zbatimit të këtyre standardeve gjatë viteve të ardhme. Siç shihet në statistikat e ofruara në raport përqindja e dokumenteve të publikuar në platformë është mjaft e lartë. Por vetëm publikimi i dokumenteve në platformë nuk është i mjaftueshëm pa një angazhim në informimin e palëve të interesit, motivimin e tyre për të marrë pjesë në proces të

konsultimit dhe për të dhënë kontribute si dhe informimi i tyre për rezultatet e procesit të konsultimit etj. Vërehet së metodat tjera përveç platformës dhe metodës me shkrim, nuk janë zhvilluar në nivel të mjaftueshëm gjatë vitit 2017.

Angazhimi i institucioneve duhet të shtohet në vitet në vazhdim për sigurimin e pjesëmarrjes së palëve të interesit dhe shtimin e besimit në mundësinë që ofron konsultimi i publikut në reflektimin e interesave të tyre në dokumentet që hartohen. Por kjo nuk mjafton pa një mobilizim të shtuar të palëve të interesit e sidomos atyre organizatave dhe strukturave të cilat përfaqësojnë grupe të caktuara të interesit dhe struktura të caktuara të qytetarëve.

Përveç sigurimit të pjesëmarrjes sfida e vazhdueshme do të jetë sigurimi i procesi kualitativ dhe gjithëpërfshirëse në proces të konsultimeve publike.

Kuptimi i dobisë së procesit të konsultimit për përmirësimin e politikave dhe legjislacionit nga ana e institucioneve bartëse të hartimit të tyre është një sfidë për tejkalimin e të cilës duhet të punohet në vazhdimësi sidomos nga niveli qendror i Qeverisë pra nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisjen e Mirë.

Duhet cekur se gjatë hartimit të raportit janë evidentuar vështirësi të theksuara gjatë mbledhjes së informatave për procesin e konsultimeve publike në nivel të shumicës së institucioneve. Vështirësitë janë evidentuar për informatat të cilat nuk mund të gjenerohen nga ana e platformës për konsultim me publikun, sidomos për dokumentet të cilat nuk janë konsultuar përmes platformës, numrin e pjesëmarrësve, numrin e komenteve, ato që janë pranuar apo nuk janë pranuar, faktin se në çfarë shkallë është zhvilluar procesi kualitativ i konsultimit. Një mungesë e tillë e informatave është vërejtur në shumicën e dokumenteve për të cilat nuk janë publikuar raportet e konsultimit.

Sfidat janë evidentuar gjithashtu edhe për faktin se koordinatorët për procesin e konsultimeve publike në disa raste janë ndërruar nga ana e ministrive, pastaj koordinatorët punën e konsultimeve e kanë si detyrë sekondare. Mungesa e koordinimit dhe informimi i brendshëm nëpër disa ministri gjithashtu paraqet një nga problemet që ndikon në zhvillimin e kualitetit të konsultimeve e në veçanti në raportimin sa më të saktë në nivel qendror siç kërkohet me rregullore.

Përveç ngritjes së kapaciteteve, informimit dhe ngritjes së vetëdijes, si sfidë paraqet fakti që Departamentet Ligjore dhe DIEKP-të në nivel të ministrive si dhe Zyrat në nivel të Zyrës së Kryeministrit, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Zyra Ligjore dhe Zyra për Planifikim Strategjik duhet të jenë strikte në moslejimin e përcjelljes së dokumenteve për aprovim në Qeveri nëse standardet minimale të konsultimeve publike nuk janë plotësuar paraprakisht.

16. Hapat dhe veprimet që do të ndërmerren për përmirësim të procesit të konsultimeve me publikun

Për fazat e ardhme të procesit të konsultimeve publike Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit duhet të fokusohet në:

- Angazhim më i shtuar në sigurimin e një procesi kualitativ të konsultimit publik. Kjo do të thotë se përveç sigurimit të plotësisht formal të standardeve, kërkohet qasje pro-aktive nga ana e ministrive në sigurimin e përfshirjes së palëve të interesit në proces të konsultimeve publike. Kjo mund të bëhet përmes:
 - Shtimit të bashkëpunimit me organizata ombrellë apo atyre që përfaqësojnë palët e interesit, si organizatat e shoqërisë civile, odat ekonomike, organizatat që përfaqësojnë profesione të lira etj.
 - Vazhdimin të ngritjes së kapaciteteve të ministrive në standardet minimale për procesin të konsultimeve publike, përmes trajnimeve apo takimeve me ministrinë, e në veçanti ofrimin e mentorimit apo mbështetjes gjatë punës së hartimit të dokumenteve. Pilotimi i tri konsultave gjatë fillimit të vitit 2017 i bërë përmes mentorimit paraqet një shembull suksesi në këtë qasje.
- Bashkëpunim më të madh i zyrave në nivel të Zyrës së Kryeministrit dhe qasje më rigorozë për të mos lejuar dokumentet që nuk i plotësojnë standardet minimale të përfshihen në agjendën e Qeverisë.
- Bashkëpunim më të madh dhe qasje më rigorozë e departamenteve përkatëse në ministri gjegjësisht DIEKP dhe departamente ligjore dhe qasje më rigorozë e tyre për të mos lejuar që dokumentet që nuk i plotësojnë standardet minimale të procedohet në qeveri për miratim.
- Do të punohet në përmirësimin e procesit të përmirësimit e të dhënave dhe raportimit në mënyrë që të sigurohen të dhëna të sakta dhe të besueshme. Sidomos të dhënat që rrjedhin nga procesi i konsultimit nga metodat e tjera përveç platformës elektronike (takime publike, konferenca etj.)
- Për këtë qëllim rekomandohet që raportimi nga koordinatorët e ministrive tek ZQM të bëhet gjatë gjithë vitit ose në baza të rregullta mujore ose tremujore.
- Do të ndërmerren fushata në ngritjen e vetëdijes dhe informatave për platformën elektronike të konsultimeve për OJQ-të, qytetarët dhe palët tjera të interesit.

- Do të punohet në përmirësimin e lëshimeve teknike që rrjedhin nga platforma elektronike. Si dhe përmirësimin të disa segmenteve që janë evidentuar gjatë aplikimit praktik të saj.
- Do të punohet që Platformës ti shtohet segmenti i gjenerimit të informatave dhe statistikave në mënyrë automatike për raportim si dhe të avancohet sistemi për tu përballur më kërkesat e reja.
- Do të zhvillohet dhe funksionalizohet mundësia për regjistrimin e përdoruesve të tij duke evituar pengesat që pengojnë regjistrimin.
- Raportet vjetore të ardhshme, do të sjellin të dhëna më cilësore përmes intervistave ose anketimeve midis koordinatorëve të konsultimeve publike dhe/ose zyrtarëve të tjerë përgjegjës, si dhe ndërmjet OSHC-ve.
- Përveç platformës do të përdoren metodat të përshtatshme tjera të konsultimit për kategori të caktuara të palëve të interesit.

Shtojca 1: Tabela e të gjitha të dhënave të përmbledhura nga Ministritë e linjës.



TRANSPARENCË LLOGARIDHËNJE GJITHËPËRFSHIRJE

Adresa:

Ndërtesa e Qeverisë
Zyra e Kryeministrit
Zyra për Qeverisje të Mirë
Kati 6. Nr. 602
Tel. +381 (0) 38 200 14 070
Email. habit.hajredini@rks-gov.net
<http://zqm.rks-gov.net>
<http://konsultimet.rks-gov.net>